



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr.458/2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Koalicionit për Kosovën e Re me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 13.12.2010, mori këtë:

### VENDIM

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Koalicionit Kosova e Re

### ARSYETIMI

Më datën 12.12.2010 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Koalicioni për Kosovën e Re në të cilën theksohet se në gjimnazin “Ulpiana”, dhe në muret e shkollave të mesme “Adem Gllavica” dhe “Vllezrit Frasheri” janë vendosur posterat PDK-se. Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

*3.6 (c) Hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi te gjitha shkresat e lendes gjeti se:

**-ankesa është e pabazuar**

PZAP-i konstaton se ankesa është e parregullt për faktin se nuk i përmban elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së dhe elementet e parashikuara në nenin 3.6 pika c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, për shkakun se parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tij. Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 458/2010 më datën 13.12.2010

**Kryesuesi i Panelit**

**Muharrem Shala**

